



## RAPORTI VJETOR PËR AFTËSINË E KUFIZUAR

Kosova Gjithëpërfshirëse



DHJETOR 3, 2020

DUKAGJIN KELMENDI & LATIFE NEZIRI  
Kontributet: HANDIKOS, SHKSH dhe SHVK

*Ky raport është pjesë e projekti të mbështetet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë*

*“Promovimi gjithëpërfshirës në proceset konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, nacional dhe regjional”*

*Zbatohet nga HANDIKOS, në partneritet me Disability Partnership Finland, Threshold, Shoqatën Kosovare të Shurdhërve dhe Shoqatën e të Verbërve të Kosovës*

**Përmbajtja e këtij raporti nuk pasqyron mendimin zyrtar të Bashkimit Evropian. Përgjegjësia për informacionin dhe pikëpamjet e shprehura në raport bie plotësisht mbi autorin (ët).**

## Përmbajtja

Shkurtesat .....	3
Hyrja .....	4
Përmbledhja ekzekutive .....	5
Fushat e Intervenimit dhe Aktivitetet.....	8
COVID 19.....	8
Qasja.....	11
Edukimi.....	12
Punësimi dhe kujdesi social .....	13
Pjesëmarrja publike .....	15
Bashkëpunimi ndërkombëtarë .....	16
Zhvillime te tjera.....	17
Rekomandimet.....	18

## AKRONIMET

**DPF** - Disability Partnership Finland

**FKAK** - Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar

**HANDIKOS** - Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës

**IKSHPK** - Instituti Kombëtare i Shëndetësisë Publike të Kosovës

**KDPAK** - Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar

**MASH** - Ministria e Arsimit dhe Shkencës

**MPMS** - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

**OBSh** - Organizata Botërore e Shëndetësisë

**OKB** - Organizata e Kombeve të Bashkuara

**OPAK** - Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuar

**PAK** - Persona me Aftësi të Kufizuara

**QBMK** - Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim

**SHKSH** - Shoqata Kosovare e të Shurdhërve

**SHVK** - Shoqata e të Verbërve të Kosovës

**SHSKUK** - Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës

**UNICEF** - United Nations Children's Fund

**ZQM** - Zyra për Qeverisje të Mirë

## Hyrje

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë “Promovimi gjithëpërfshirës në proceset konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, nacional dhe regional”, tutje “Kosova Gjithëpërfshirëse”, i cili zbatohet nga HANDIKOS, në partneritet me Disability Partnership Finland, Threshold, Shoqatën Kosovare të Shurdhërve dhe Shoqatën e të Verbërve të Kosovës.

Projekti synon të ketë një ndikim në çështjen e aftësisë së kufizuar në Kosovë me tendencën e pritur për arritjen e një “Shoqëria gjithëpërfshirëse në të cilën personat me aftësi të kufizuara realizojnë potencialin e tyre të plotë dhe jetojnë jetë me dinjitet si qytetarë të barabartë. (Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2013-2023)”. Për të realizuar këtë ndikim, njëra nga objektivat specifike të projektit është që “Reformat Qeveritare dhe të Administratës Publike të jenë gjithëpërfshirëse”. Prandaj me qëllim të arritjes së këtij rezultati, synimi i projektit është që përveç tjerash të rrisë disponueshmërinë e të dhënave për çështjet e aftësisë së kufizuar me qëllim që institucionet publike dhe OPAK-ët mund të përdorin të dhëna të besueshme si mjete për planifikim, monitorim dhe përfshirjen e iniciativave specifike për aftësinë e kufizuar.

Në reference të priturve dhe objektivave specifike të projektit, një Raport Vjetor për aftësinë e kufizuar do të përgatitet dhe publikohet çdo vit, bazuar në të gjeturat e raportit të hulumtimit lidhur me Studimin e legjislacionit aktual në Kosovë. Në kuadër të këtij aktiviteti një Raporti vjetor lidhur me aftësinë e kufizuar do të përgatitet në secilin vit të projektit. Raporti do të mbulon një listë të çështjeve të rëndësishme lidhur me kriteret e aderimit në BE, KDPAK, Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Strategjinë Evropiane për aftësinë e kufizuar. Çështje të caktuara do të zgjedhën nga ana e OPAK-ve dhe rrjeteve të tyre të cilat do të përdoren për të gjeneruar/përgatitur raportet vjetore për Aftësinë e Kufizuar. Të gjeturat nga raporti do të prezantohen për publikun në Konferencën e datës 03 Dhjetor, në ngjarjen e organizuar për shënimin e Ditës Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Të gjeturat në këtë raport për vitin 2020, janë të bazuara në të gjeturat e raportit të hulumtimit lidhur me Standardet Ndërkombëtare mbi Çështjet e Aftësisë së Kufizuar ‘Ku qëndron Kosova?’. Hulumtimi, vlerëson legjislacionin aktual të Kosovës nga pikëpamja e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Acquis Communautaire të Bashkimit Evropian, në fushat përkatëse. Vlerësimi shikon standardet ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar të kodifikuara në konventat përkatëse dhe aktet ligjore, përmes kategorive të mëtutjeshme: 1. Të drejtës për jetë dhe drejtësi, 2. Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në komunitet, 3. Qasshmëria, 4. Edukimi, 5. Liria, mbrojtja nga tortura, integriteti dhe lëvizshmëria, 6. Barabarësia, mos-diskriminimi (gratë dhe fëmijët), 7. Shëndeti, 8. Punësimi dhe kujdesi social, 9. Pjesëmarrja publike, 10. Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë. Raporti është zhvilluar gjatë vitit 2019 dhe është publikuar në fillim të vitit 2020, dhe mund të gjendet në gjuhën Shqipe, Angleze dhe Serbe në ueb faqen e HANDIKOS: <http://www.handi-kos.org/>.

Raporti i vitit 2020, është i bazuar në raportimet e OPAK-ve, monitorimi i stafit të projektit, punëtorive që janë zhvilluar gjatë vitit dhe hulumtimet në dokumente të projektit, organizatave dhe platformave online.

## Përmbledhje Ekzekutive

Raporti i Hulumtimit lidhur Standardet Ndërkombëtare mbi Çështjet e Aftësisë së Kufizuar 'Ku qëndron Kosova?', ka identifikuar dhjetë (10) fusha kryesore që përmbajnë standardet ndërkombëtare në fushën e aftësisë së kufizuar që derivojnë nga Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar. Gjatë vitit 2020, OPAK-ët kanë kryer intervenime në 5 nga 10 fushat e identifikuara, që janë: Qasja, Edukimi, Punësimi dhe Mirëqenia, Pjesëmarrja Publike dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtarë. Për shkak të pandemisë COVID 19, shumë intervenime janë bërë në fusha të ndryshme që janë lidhur me parandalimin e virusit dhe masat qeveritare kundër pandemisë. Prandaj COVID 19, do të përfshihet në këtë raport edhe pse nuk është në fushat e hulumtuara.

Për shkak të fillimit të pandemisë COVID 19 dhe në harmoni me masat ndërkombëtare dhe masat e Qeverisë së Kosovës, OPAK-ve iu është obliguar që të adaptojnë zbatimin e programeve të tyre në harmoni me këto masa. Në referencë të udhëzimeve që janë shpërndarë nga OKB-ja dhe OBSH-ja, në Kosovë OPAK-ët kanë reaguar në fushën e shëndetësisë, qasshmërisë, edukimin-arsimin dhe mirëqenien socio ekonomike për personat me aftësi të kufizuar, me qëllim që masat qeveritare kundër COVID 19, të jenë gjithëpërfshirëse dhe të adresojnë edhe nevojat e komunitetit të aftësisë së kufizuar.

Qasshmëria është njëra nga fushat e intervenimeve nga lista e standardeve ndërkombëtare, në raport edhe me kufizimet për shkak të pandemisë dhe ndryshimit të mënyrave të intervenimit kanë përfshirë qasjen fizike për personat me aftësi të kufizuar fizike, qasjen në informacion përmes mjeteve dhe platformave ekzistente për personat nga komuniteti i të shurdhërve dhe të verbërve. Edukimi është gjithashtu një fushë e rëndësishme nga lista e standardeve që ka trajtuar në veçanti specifikat e komunitetit të shurdhërve në qasjen në gjuhën e shenjave dhe interpretimin në këtë gjuhë dhe nevojat e komunitetit të verbërve për krijimin e sintezës vokale në gjuhën shqipe, me qëllim që këto dy komunitetet të kenë qasje në edukim, arsim dhe informacion. Punësimi dhe kujdesi social, është kategoria tjetër shumë e rëndësishme e standardeve ndërkombëtare që adreson ofrimin e mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës dhe posaçërisht në rastin e Kosovës në zbatimin e legjislacionit që adreson këtë komponentë të këtij standardi. Pjesëmarrja dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë janë gjithashtu fusha të rëndësishme në kuadër të standardeve të kërkuara për mbrojtje dhe realizimin e të drejtave për personat me aftësi të kufizuar.


Organizatat e personave me aftësi të kufizuar së bashku me institucionet publike do të përdorin të dhënat e raportit për të avancuar agjendën e çështjeve të aftësisë së kufizuar për të garantuar standarde të pranueshme krahas kërkesave të legjislacionit dhe politikave evropiane. Në këtë kontekst gjatë vitit 2020, OPAK-et i kanë intensifikuar veprimet e tyre me qëllim që të avancohen çështjet që lidhen me fushat e identifikuar në këtë raport. COVID 19 dhe ndryshimet e shpeshta politike, i kanë afektuar në mënyrë të konsiderueshme aktivitetet që lidhen me intervenimet për secilën nga këto fusha. Andaj, intervenimet kanë qenë racionale dhe mënyra ka ndryshuar në mase.

Të dhënat nga ky raport dhe raporti i hulumtimit janë të dhëna kuantitative më shumë se sa kualitative, sepse deri me tani të dhënat nga hulumtimet dhe monitorimi është fokusuar në ekzistencën e kornizës ligjore për trajtimin e standardeve të kërkuara. Një hulumtim lidhur me zbatimin e legjislacionit aktual do të mund të na ofronte të dhëna kualitative lidhur me zbatimin në praktikë të këtyre standardeve. Hulumtime kualitative në këtë kontekst do të bëhen viteve në vazhdim.

Megjithatë, në baze të gjeturave ne rekomandojmë që institucionet qeveritare te nivelit qendror dhe lokal të sigurojnë zbatimin e kornizës ligjore aktuale dhe aprovimin e legjislacionit plotësues për drejtat e personave me aftësi të kufizuar në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionit evropian për aftësinë e kufizuar.

## Standardet e hulumtimit


### FUSHAT E HULUMTIMIT



- E drejta për jetë dhe drejtësi
- Qasja
- Liria, mbrojtja nga tortura, integriteti dhe lëvizja
- Shëndeti
- Pjesëmarrja publike
- Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në komunitet
- Arsimi
- Barazia, mosdiskriminimi (gratë dhe fëmijë)
- Punësimi dhe kujdesi social
- Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

### FUSHAT E INTERVENIMIT-2020

- COVID 19
- Edukimi
- Pjesëmarrja publike
- Qasshmëria
- Punësimi dhe kujdesi social
- Bashkëpunimi ndërkombëtarë





## Fushat e Intervenimit dhe Aktivitetet

### 1.COVID 19

COVID-19 ka krijuar një krizë njerëzore të një shkalle të tillë e cila nuk ka qenë e përjetuar deri më tani dhe e cila ka ndikuar në mënyrë dis-proporcionale edhe tek personat me aftësi të kufizuara. Si e tillë kjo situatë kërkoi një përgjigje të pa zbatuar më parë - një qasje të jashtëzakonshme të mbështetjes së personave me aftësi të kufizuara. Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK) vepruan krahas mundësive të tyre për të mbështetur anëtarët e tyre, gjithmonë në harmoni me rekomandimet, instruksionet dhe dokumentet tjera relevante të cilat janë publikuar nga OKB, OBSH, IKSHKP dhe Qeveria e Kosovës. Qëllimi kryesorë ishte për tu siguruar që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në shërbimet bazike, përfshirë shërbimet e menjëhershme shëndetësore dhe të mbrojtjes sociale, për të kapërcyer krizën.

Dokumentet e publikuara nga OKB në referencë të pandemisë COVID 19, prezantuan të gjeturat, udhëzimet dhe rekomandimet të cilat OPAK-ët në Kosovë i zbatuan gjithmonë duke u fokusuar në nevojat dhe specifikat e anëtarëve të cilët përfaqësonin. Rekomandimi kryesorë i OKB-së ishte se një reagim për rimëkëmbje nga COVID 19 duke përfshirë aftësinë e kufizuar do t'i shërbejë më mirë të gjithëve. Këto rekomandime specifike ishin përqendruar në sektorët kryesorë që përfshinin katër fusha kryesore të veprimit të zbatueshme për të gjithë: 1. Sigurimi i integritit të aftësisë së kufizuar në të gjitha veprimet e rikuperimit nga COVID-19; 2. Sigurimi i qasjes në informata, pajisje, shërbime dhe programe në përgjigjen dhe rikuperimin nga COVID-19; 3. Sigurimi i konsultimeve kuptimplota me pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese në të gjitha fazat e përgjigjes dhe rimëkëmbjes COVID-19; 4. Krijimi i mekanizmave për të siguruar përfshirjen e aftësisë së kufizuar në përgjigjen ndaj COVID-19.<sup>1</sup>

Raporti i OKB-së, gjithashtu ka prezantuar një gamë të gjerë të ndikimit të COVID-19, tek personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe implikimet afatshkurtra dhe afatgjata. Ndër të tjera është konkluduar, se: Personat me aftësi të kufizuara janë në rrezik më të madh të infeksionit nga COVID-19; kanë rrezik më të madh për të zhvilluar gjendje më të rëndë shëndetësore dhe vdekje; personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në institucione kanë më shumë gjasa të preken nga virusi dhe kanë nivele më të larta të vdekshmërisë; të njëjtit janë veçanërisht në dis-avantazh nga pasojat socio-ekonomike dhe masat për të kontrolluar pandeminë; ndikimi në punësim dhe mbrojtje sociale; arsim; shërbimet mbështetëse; dhe ndikimet e dhunës tek personat me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst, raporti ka ofruar një sërë rekomandimesh për të siguruar një reagim dhe rimëkëmbje adekuate për personat me aftësi të kufizuara me theks në orientimin në fushat siç janë: qasja, pjesëmarrja, llogaridhënia dhe ndarja e të dhënave.<sup>2</sup> Ndërsa, zbatimi i masave mbrojtëse që janë kërkuar nga OKB dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, janë si në vijim: **Shëndeti/sigurimi i qasjes në informata për shëndetin publik**; zbatimi i masave mbrojtëse kundër COVID-19; sigurimi i qasjes në shërbime; sigurimi i mos-diskriminimit në alokimin e resurseve të pakta mjekësore; ndërhyrje gjithëpërfshirëse në shëndetin mendor të personave me aftësi të kufizuara; **Mbrojtja e personave të vendosur në institucione/** ulja e numrit të njerëzve brenda institucioneve; **Shërbimet mbështetëse/sigurimi i vazhdimësisë së shërbimeve mbështetëse**; zgjerimi mbështetjes së

<sup>1</sup> United Nation/Policy Brief/ A Disability –Inclusive Response to COVID-19, May 2020 <https://reliefweb.int/report/world/policy-brief-disability-inclusive-response-covid-19-may-2020>

<sup>2</sup> United Nation/Policy Brief/ A Disability –Inclusive Response to COVID-19, May 2020 <https://reliefweb.int/report/world/policy-brief-disability-inclusive-response-covid-19-may-2020>

komunitetit për personat me aftësi të kufizuara; **Mbrojtja sociale dhe punësimi; Edukimi-Arsimi/** adresimi i ndikimeve që shkojnë përtej të mësuarit; **Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës/** sigurimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të arritshme të mbështetjes ndaj viktimave: ngritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive: dhe **Kontekstet Humanitare**<sup>3</sup>.

Në referencë të këtyre rekomandimeve dhe udhëzimeve të dhëna në kuadër të masave qeveritare, OPAK-ët në Kosovë (HANDIKOS, Shoqata Kosovare e të Shurdhërve, Shoqata e të Verbërve të Kosovës dhe Forumit Kosovar për Aftësinë e Kufizuar), gjatë vitit 2020, kanë bërë intervenime të ndryshme për të adresuar sfidat ndaj pandemisë COVID 19.

Aktiviteti primar ishte identifikimi i nevojave të personave me aftësi të kufizuara në fillim të situatës emergjente dhe dorëzimi i tyre në institucionet përkatëse. OPAK-ët, bazuar në nevojat e identifikuar të personave nga komuniteti i tyre i aftësisë së kufizuar, u mobilizuan për të ofruar shërbime dhe përkrahje përmes formave të ndryshme krahas masave qeveritare. Nevojat dallojnë, varësisht prej llojit të aftësisë të kufizuara dhe sidomos prioritetet. Personat nga komuniteti i aftësisë së kufizuar të shurdhër dhe të verbër, si prioritet kanë identifikuar nevojën për qasje në informacion me qëllim që të marrin informata lidhur me parandalimin dhe reagimin gjatë situatës së pandemisë, si dhe të njoftohen për masat qeveritare. Ndërsa personat me aftësi të kufizuar fizike, në prioritetet e nevojave të tyre kanë identifikuar kërkesat shëndetësore si dhe masat adekuate lidhur me parandalimin nga infektimi me virusin COVID 19. Përderisa, edukimi dhe arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara nga të gjitha komunitetet e aftësisë së kufizuar është konsideruar sfidë në kohën e pandemisë. Mirëqenia socio-ekonomike është identifikuar si një prioritet i përbashkët për faktin se personat me aftësi të kufizuar edhe në situata të zakonshme konsiderohen si komuniteti më i varfër, ndërsa kjo situatë është keqësuar edhe më gjatë periudhës së pandemisë.

Prandaj në kuadër të intervenimeve në lidhje me masat kundër COVID 19, OPAK-ët kanë bërë intervenime në fushën e : shëndetësisë, qasshmërisë, edukimit-arsimit dhe mirëqenies socio ekonomike, si më poshtë:

Në referencë të nevojave themelore për personat me aftësi të kufizuara, HANDIKOS në bashkëpunim me rrjetin lokal në të gjithë Kosovën, në përgjigje të nevojave shëndetësore, vetëm gjatë muajit Prill dhe Maj 2020 më shumë se 300 Persona me Aftësi të Kufizuara në të gjithë Kosovën janë furnizuar me pajisje themelore mjekësore (katetera, dezinfektues; dorëza sterile; maska; qese urinare; kondoma urinare). Për më tepër, për raste urgjente, departamenti për shpërndarjen e pajisjeve ndihmëse brenda HANDIKOS ka funksionuar me të gjitha parametrat e nevojshëm mbrojtës dhe ka shpërndarë një numër të konsiderueshëm të karrocave dhe pajisjeve të tjera. HANDIKOS i ka ofruar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Klinikës Infektive mbështetje me pajisjet ndihmëse për pacientët Covid 19.

OPAK-ët nga niveli nacional dhe lokal kanë shkëmbyer përvoja lidhur me adresimin e situatës emergjente dhe mënyrës së mbështetjes së personave me aftësi të kufizuara dhe së bashku kanë punuar për plotësimin e nevojave më të domosdoshme shëndetësore të personave me aftësi të kufizuara në të gjithë Kosovën, përfshirë hartimin dhe shpërndarjen e posterëve të zhvilluar me informata për COVID-19 si dhe video tutoriale janë shpërndarë dhe përdorur nga ata. HANDIKOS ka mbështetur personat me aftësi të kufizuara virtualisht përmes mediave sociale dhe platformave të tjera online duke publikuar video-mesazhe dhe informata në lidhje me COVID-19 dhe mënyrat për parandalimin e infektimit. Njëkohësisht

---

<sup>3</sup> United Nation/Policy Brief/ A Disability –Inclusive Response to COVID-19, May 2020  
<https://reliefweb.int/report/world/policy-brief-disability-inclusive-response-covid-19-may-2020>

janë zhvilluar dhe shpërndarë video-mësime për fëmijë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara dhe udhëzime online lidhur me përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të tyre ndihmëse. Për të adresuar aspektin e izolimit social gjatë situatës së pandemisë janë mbajtur edhe dy (2) sesione informative, një për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe një (1) me personat e rritur me aftësi të kufizuara. Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara u mbështetën virtualisht përmes grupit të tyre të mbyllur në Facebook për të përballuar COVID-19 dhe për të mbështetur fëmijët e tyre, me të njëjtin qëllim u zhvilluan sesione të drejtpërdrejta dhe video tutoriale. Grupi i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara 'HËNA' organizoi në vazhdimësi takime virtuale gjatë kësaj periudhe për të shpërndarë aktivitetet të cilat duhet zbatuar dhe idetë se si të jenë aktivë gjatë izolimit. Shërbimet të cilat më herët ofroheshin për jetesë të pavarur dhe rehabilitim në qendrat e HANDIKOS, tani janë adaptuar për tu ofruar përmes platformave online.

Shoqata Kosovare e të Shurdhërve, ndërmori veprime të shumta për tu kujdesur që anëtarët e saj janë mirë të informuar duke ju ofruar qasje në informatat më të reja përmes gjuhës së shenjave. Interpretimi i gjuhës së shenjave sigurohej në konferencat për shtyp të organizuara nga Ministria e Shëndetësisë si dhe në lajmet e Televizionit publik. SHKSH me përkrahje të Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuara FKAK organizuan sesione të shumta informimi në lidhje me Covid 19 si dhe aktivitete me fëmijë të shurdhër përmes platformës në internet. Vetëm gjatë muajit Prill 2020, në kohën kur informatat ishin më se të nevojshme për të gjithë, SHKSH prodhoi 14 video-informata në gjuhën e shenjave të cilat u publikuan në faqen zyrtare dhe në faqen e rrjetit social Facebook të SHKSH, kjo praktikë ka vazhduar gjatë tërë vitit. Rezultate tjera gjatë kësaj periudhe kohore janë edhe lansimi i "Fjalorit Elektronik" të gjuhës së shenjave si dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm i SHKSH me Ministrinë e Arsimit lidhur me angazhimin e interpretuesve të gjuhës së shenjave si asistent në shkollat për fëmijët e shurdhër.

Shoqata e të Verbërve të Kosovës, gjithashtu në përpjekje për të bartur informacionin e nevojshëm tek anëtarët e saj, zhvilloi dhe përdori qasjen që përmes mediave sociale personat e verbër u informuan për kufizimin e lëvizjes së lirë, masat mbrojtëse kundër pandemisë, përfshirë udhëzimet për aplikim për "leje zyrtare" për t'u larguar nga shtëpitë e tyre në raste të nevojës. SHVK në bashkëpunim me FKAK shtypi broshurën në alfabetin Brail për personat e verbër në lidhje me situatën e pandemisë Covid19, e cila u mbështet financiarisht nga CDF dhe iu shpërnda njerëzve të verbër në tërë Kosovën.

Përveç implikimeve shëndetësore dhe qasjes në informacion, një sfidë tjetër e periudhës së pandemisë ishte dhe Edukimi/Arsimi i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor në Kosovë, ishte një ndër prioritetet e Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK) me qëllim të mbështetjes së tyre në përcjelljen e programeve arsimore të organizuara nga MASH gjatë kohës së pandemisë me Covid 19. Forumi i Kosovës për Aftësi të Kufizuara së bashku me OPAK-ët kanë organizuar takime të shumta me MASH, UNICEF dhe Organizata të tjera ndërkombëtare për të reaguar me veprimet e tyre ndaj kësaj sfide. FKAK me mbështetje nga UNICEF filloi me implementimin e Projektit "Integrimi dhe Koordinimi i shërbimeve në internet për fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë". Objektivi i këtij Projekti ishte implementimi i shërbimeve arsimore në internet për fëmijët e shurdhër dhe të verbër. HANDIKOS, gjithashtu përmes përkrahjes së donatoreve të ndryshëm ka arritur të sigurojë "tablet" për fëmijët me aftësi të kufizuara me qëllim që përmes këtyre pajisjeve tu mundësojë vijimin e programit arsimor i cili tanimë zhvillohej "online" nga Ministria e Arsimit.

Pandemia COVID 19, ka ndikuar edhe në "Mirëqenien sociale dhe punësimin" e personave me aftësi të kufizuara dhe familjareve të tyre. Në listën e nevojave të identifikuara nga OPAK-et, ishte edhe nevoja për ndihme materiale për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre. OPAK-et organizuan takime të

shumta me institucionet relevante për të gjetur mënyrat e përkrahjes së personave me aftësi të kufizuara gjatë krizës ekonomike të cilën shkaktonte pandemia. Si rezultat i avokimit të OPAK-ve, personat me aftësi të kufizuara u përshinë në pakon e parë emergjente financiare tre (3) mujore me të cilën personat me aftësi të kufizuara të cilët përfitonin asistencë sociale nën shumën 100 Euro, përfituan ngritje prej 25%. Kjo praktike nuk u aplikua në pakot emergjente të radhës. Me përkrahjen e shumë donatorëve OPAK-et, kanë bërë shpërndarjen e pakove higjienike dhe pakove ushqimore për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre të cilët ishin vlerësuar si më të rrezikuara në aspektin e mirëqenies sociale.

Situata e pandemisë është ende duke vazhduar dhe kërkesat për ti adresuar aspektet shëndetësore, edukative dhe të mirëqenies ekonomike të personave me aftësi të kufizuara vazhdojnë të mbesin prioritetet kryesore të OPAK-ve.

## 2. Qasshmëria

Raporti I Hulumtimit<sup>4</sup>, gjene se qasja është ndër kategoritë dhe standardet më të rëndësishme e cila është e përfshirë vetëm 6.77% në legjislacionin e Kosovës, ndërsa është adresuar pjesërisht 79.67%, dhe 13.55% e standardeve mungojnë ose nuk janë përfshirë fare në legjislacionin e Kosovës.

Me qëllim të lehtësimin të komunikimit, qasjes në informacion, mjedis fizik, transport, organizatat e personave me aftësi të kufizuara janë angazhuar përmes avokimit, lobimit, takimeve dhe bashkëpunimit me institucione publike dhe private të avancojnë pozitën e komunitetit të tyre në raport me standardet e kërkuara. Në referencë të këtyre fushave, janë ofruar 2442 orë shërbime interpretimi për institucione publike në periudhën Janar-Shtator, është hartuar Draft Marrëveshja për krijimin e Sintezës Vokale në Gjuhën Shqipe në mes të dy ministrive përkatëse të Kosovës dhe të Shqipërisë, intervenime të ndryshme avokuese përmes takimeve dhe platformave tjera janë zbatuar, me theks të veçantë në Komunën e Prishtinës, për heqjen dhe eliminimin e barrierave fizike në qytet dhe institucione publike dhe një takim është zhvilluar edhe me përfaqësuesin e Dhomës së Arkitekteve me qëllim që në sektorin privat dhe posaçërisht në fazat e marrjes së lejes ndërtesat private të përmbahen kriteret e Udhëzimit Administrativ<sup>5</sup>. Për të mundësuar lëvizjen e lirë dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, HANDIKOS, gjatë periudhës së pandemisë ka shpërndarë 200 karroca, 35 shëtitore, 20 pale kukëza, 15 shtretër, 25 karroca tualeti dhe 13 karrige tualeti dhe pajisje tjera mbështetëse. Me të njëjtin qëllim, HANDIKOS në bashkëpunim me UNICEF organizuan fushatën për ngritjen e vetëdijes lidhur me lëvizjen e lire duke vendosur një instalacion me 120 karroca në sheshin kryesor të kryeqytetit.

Ofrimi i shërbimeve të gjuhës së shenjave është e rregulluar me akt të Qeverisë<sup>6</sup>, e cila obligon “ Të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, në nivel qendror dhe atë lokal, që personave nga komuniteti i të shurdhërve t’i ofrojnë shërbim sipas nevojës dhe kërkesave në gjuhën e shenjave. Megjithatë konsiderohet se kjo rregullore nuk është duke u zbatuar në tërësi, sidomos në nivel lokal. Mungesa e sintezës vokale në gjuhën shqipe, u ka pamundësuar personave të verbër që të kenë qasje në të gjitha llojet e informatave dhe e ka vështirësuar komunikimin e tyre si në aspektin personal ashtu dhe

<sup>4</sup>Rozafa Basha dhe Hajrulla Çeku/ Standardet Ndërkombëtare mbi Çështjet e Aftësisë së Kufizuara ‘Ku qëndron Kosova?, Prishtinë, Mars 2020

<sup>5</sup> UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR KUSHTET TEKNIKE TË OBJEKTEVE NDËRTIMORE PËR QASJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA, [https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/161021105153\\_udhezimi\\_administrativ.pdf](https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/161021105153_udhezimi_administrativ.pdf)

<sup>6</sup> Rregullore QRK Nr. 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës, është miratuar në mbledhjen e 197 të Qeverisë së Kosovës, me vendimin nr. 05/197, datë 25.09.2014

në atë profesional. Krijimi i Sintezës vokale në gjuhën shqipe do tu mundësonte personave të verbër të komunitetit shqipfolës lehtësimin e komunikimit, qasje në informacion, sisteme të ndryshme, internet dhe do të krijonte lehtësira edhe në sistemin për edukimin e personave të verbër. Heqja dhe eliminimi i barrierave fizike në qytet dhe institucione publike, do tu krijonin mundësi personave me aftësi të kufizuar ti shfrytëzojnë shërbimet njësoj sikur qytetaret e tjerë. Mungesa e qasjes fizike është një nga barrierat kryesore për personat me aftësi të kufizuar fizike për të jetuar një jetë të pavarur dhe me dinjitet, për të edukuar, për të marrë pjesë në shoqëri, sepse barrierat fizike e kufizojnë lirinë e lëvizjes.

Për qëllimet e këtij raporti janë përfshirë detyrimet e mëposhtme:

<b>Fushat e hulumtimit</b>	<b>Fusha e Intervenimet gjate vitit 2020</b>	<b>Aktivitetet/Lloji I intervenimit</b>
Qasja e barabartë në mjedis fizik, transport, TIK dhe lehtësira dhe shërbime të tjera	E aplikuar	Takimeve me zyrtare publik, përmes mediave vizuale, rrjeteve sociale,
Standardet minimale dhe udhëzimet e qasjes/	E aplikuar	Takimeve me zyrtare publik, përmes mediave vizuale, rrjeteve sociale,
Kompanitë private heqin barrierat dhe nuk vendosin të reja	NA	
Trajnimi i palëve të interesuara relevante për qasjen e personave me aftësi të kufizuara/	NA	
Format për lehtësimin e komunikimit përmes Brail-it dhe udhëzuesve të tjerë (interpretuesit e gjuhës së shenjave)/	E aplikuar	Shërbime interpretimi për institucione publike, Draft marrëveshja për krijimin e Sintezës vokale në Gjuhën Shqipe në mes dy ministrive, Kosovës dhe asaj të Shqipërisë
Qasja në informacion, sisteme, internet	E aplikuar	Shërbime interpretimi për institucione publike,
Kërkesat e qasjes janë pjesë përbërëse e projekteve ndërtimore që nga faza e projektimit/	E aplikuar	Takimeve me zyrtare publik, përmes mediave vizuale, rrjeteve sociale
Organizatrat e personave me aftësi të kufizuara konsultohen lidhur me standardet dhe normat e qasjes	NA	
Shërbimet e mediave janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara	NA	

### **3. Edukimi**

Arsimi është ndër kategoritë me rezultate të moderuara. Rreth 42% e standardeve për aftësinë e kufizuar janë të përfshira në legjisllacionin e Kosovës, 50% e standardeve janë të adresuara pjesërisht, dhe vetëm 8.33% e standardeve mungojnë ose nuk janë të adresuara fare.

Me qëllim të realizimit të së drejtës për arsim gjithëpërfshirës, mbështetjes individuale për nxënësit/studentët me aftësi të kufizuar dhe përmirësimit të qasjes së nxënësve në shkolla, trajnimit të mësuesve dhe profesionistëve të tjerë dhe aftësimin profesional të mësuesve, organizatat e personave me aftësi të kufizuar gjatë intervenimeve në vitin 2020, kanë finalizuar, publikimin e fjalorit të parë elektronik të gjuhës së shenjave kosovare me më shumë se 2700 shenja dhe 150 fjali, është avancuar çështja e pajisjeve tiflo teknike dhe tiflo didaktike për nxënësit e verbër-disa pajisje janë siguruar për komunitetin e të verbërve, ndërsa në QBMK Pejë është bërë ngritja e kapaciteteve të stafit profesional. Gjithashtu, që nga shpallja e pandemisë, duke i shfrytëzuar platformat e shërbimeve “online” të ofruara për komunitetin e të verbërve janë identifikuar nevojat e tyre, të cilat janë adresuar tek institucionet përgjegjëse si në fushën e edukimit, arsimimit, shëndetësi, mirëqenie dhe shërbime administrative në forma të ndryshme.

Arsimi gjithëpërfshirës për nxënësit me aftësi të kufizuar në përgjithësi dhe nxënësit e shurdhët në veçanti është larg si qëllim, sepse mungojnë shkathtësitë dhe burimet njerëzore në shkolla të Kosovës për ta adresuar në mënyrë të duhur këtë sfidë. Pajisjet tiflo teknike dhe tiflo didaktike janë pajisje obliguese sipas ligjit dhe shtrihen nën kompetencën e ministrive të linjës si: MPMS, MSH dhe MASH.

Për qëllimet e këtij raporti janë përfshirë detyrimet e mëposhtme:

Fushat e hulumtimit	Fusha e Intervenimet gjate vitit 2020	Aktivitetet/Lloji I intervenimit
E drejta për arsim gjithëpërfshirës	E aplikuar	Publikimi i fjalorit të parë elektronik te gjuhës se shenjave kosovare me më shume se 2700 shenja dhe 150 fjali.
Parandalimi i mohimit të së drejtës së arsimit në bazë të aftësisë	NA	
Nxënësit me aftësi të kufizuara ndjekin mësim të rregullta në shkollë	NA	
Detyrimet e shkollave për të përmirësuar qasjen për nxënësit e shkollës me aftësi të kufizuara/	E aplikuar	Takimet e OPAK-ve me Ministrinë e Arsimit.
Parandalimi i diskriminimit të vajzave me aftësi të kufizuara në qasjen në arsim/	NA	
Mbështetja individuale për nxënësit dhe studentët	E aplikuar	Sigurimi i pajisjeve për komunitetin e të verbërve
Punësimi i mësuesve (duke përfshirë ata me aftësi të kufizuara) që zotërojnë gjuhën e shenjave dhe gjuhën Brail.	NA	*Punësimi i asistentëve është në proces.
Trajnimi i mësuesve dhe profesionistëve të tjerë për arsim gjithëpërfshirës	E aplikuar	Në QBMK Pejë është bërë ngritja e kapaciteteve të stafit profesional nga ana e MASH

#### 4. Punësimi dhe kujdesi social,

Punësimi dhe kujdesi shoqëror është vlerësuar përmes detyrimeve (standardeve) të cilat pak më shumë se një e treta (38,88%), e tyre janë përfshirë në legjislacionin e Kosovës, 44.45% janë adresuar pjesërisht ndërsa 16.66% mungojnë apo nuk janë adresuar fare.

Zbatimi i ligjit<sup>7</sup>, gjatë vitit 2020, ka qenë fokusi kryesor për avokim nga organizatat e personave me aftësi të kufizuara. OPAK-et në vazhdimësi kane avokuar tek institucionet vendore, përmes takimeve, mediave dhe rrjeteve sociale, lidhur me zbatimin e ligjit dhe realizimin e garancive që ofron ligji. Në të njëjtën kohë është punuar për gjetjen e alternativave sekondare për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, dhe disa projekte janë paraqitur në frymën e zhvillimit të ndërmarrësisë sociale ku persona me aftësi të kufizuara do të punësoheshin. Në reference të kësaj, së shpejti HANDIKOS do të fillojë së zbatuari projektin e financuar nga “Swiss Cooperation” dhe ku personat me aftësi të kufizuara do të fillojnë të punojnë dhe do të gjenerojnë të ardhura. Në këtë kontekst është intervenuar tek institucionet lidhur me problematiken e shërbimeve për personat e verbër. Zbatimi i këtij ligji i adreson disa fusha të mbrojtura me dokumente ndërkombëtare ashtu siç janë gjetur edhe në raportin e hulumtimit dhe që janë: e drejta për të fituar të ardhura për jetesë nga një punë që u siguron qasje personave me aftësi të kufizuara; ndalimi i diskriminimit në punësim në bazë të aftësisë së kufizuar; mundësitë e barabarta në kushte të punës, pagesë, karrierë dhe mbrojtje nga ngacmimi; qasja efektive e personave me aftësi të kufizuara në programet e arsimit profesional, mundësitë e punësimit dhe zhvillimin e karrierës.

Bazuar në të dhënat aktuale, në Kosovë vetëm 0.1 për qind e personave me aftësi të kufizuara janë të punësuar. Ky numër simbolik i të punësuarve ka shqetësuar në vazhdimësi organizatat që merren me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar. Nga një statistike e thjeshtë e përgatitur nga institucionet e Kosovës, në referencë të raportimit mbi objektivat e Planit Nacional të Veprimit për PAK, rezulton se për një periudhë 1 vjeçare janë të regjistruar si punëkërkuar me aftësi të kufizuara: për grup moshat 15- 24 vjeçare janë gjithsejtë 24 persona, (9 femra dhe 15 meshkuj), ndërsa për grup moshat 25-39, janë gjithsejtë 156 persona, 51 Femra dhe 105 meshkuj. Ndërsa, nga ky numër vetëm 3 persona janë punësuar përmes ndërmjetësimin në punësim, 2 femra dhe 1 mashkull.

Për qëllimet e këtij raporti janë përfshirë detyrimet e mëposhtme:

<b>Fushat e hulumtimit</b>	<b>Fusha e Intervenimet gjate vitit 2020</b>	<b>Aktivitetet/Lloji I intervenimit</b>
E drejta për të fituar të ardhura për jetesë nga një punë që u siguron qasje personave me aftësi të kufizuara	E aplikuar	Avokim për Zbatimin të Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi te Kufizuara
Ndalimi i diskriminimit në punësim në bazë të aftësisë së kufizuar	E aplikuar	Avokim për Zbatimin të Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi te Kufizuara ,
Mundësitë e barabarta në kushte të punës, pagesë, karrierë dhe mbrojtje nga ngacmimi/	E aplikuar	Avokim për Zbatimin të Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi te Kufizuara ,
Qasja efektive e personave me aftësi të kufizuara në programet e arsimit	NA	

<sup>7</sup> LIGJI NR. 05/L -078 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit NR. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi te Kufizuara, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12811> .

profesional, mundësitë e punësimit dhe zhvillimin e karrierës		
Punësimi i personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik dhe privat/	E aplikuar	Avokim për Zbatimit të Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara
Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara nga puna e detyruar	NA	
Garantimi i standardit adekuat të jetesës për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre (ushqim, veshmbathje, strehim)/	NA	
Qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në shërbimet e ujit të pijshëm/	NA	
Qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht e grave, vajzave dhe e të moshuarve me aftësi të kufizuara, në programet e përkujdesjes sociale dhe zbutjes së varfërisë	NA	
Mbështetje financiare dhe shërbimet e tjera për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e varfra	E aplikuar	Lobim për Shërbimeve për personat e verbër.
Qasja e personave me aftësi të kufizuara në programet e strehimit social	NA	
Qasja e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në programet e pensionit dhe benefitet.	NA	Takimet për përfitimin e Personave me Aftësi të Kufizuara nga pakot emergjente te Qeverise.

## 5. Pjesëmarrja publike,

Pjesëmarrja publike mbetet ndër kategoritë më sfiduese e standardeve të aftësisë së kufizuar, ku vetëm 20% e detyrimeve të mëposhtme janë përfshirë në legjislacionin e Kosovës, 20% e standardeve janë të adresuara pjesërisht, ndërsa 60% e standardeve mungojnë ose nuk janë të adresuara fare.

Organizatet e personave me aftësi të kufizuara kanë avokuar në vazhdimësi për pjesëmarrje në jetën politike dhe publike mbi baza të barabarta me të tjerët dhe për pjesëmarrje të plotë dhe jo diskriminuese në punët publike. Në referencë të kësaj të drejte, në zgjedhjet e fundit të vitit të kaluar, një person me aftësi të kufizuar është zgjedhur përmes votës qytetare deputet në Kuvendin e Kosovës. Megjithatë, i njëjti deputet është ballafaquar me barriera fizike për të qenë prezent në seancat e Kuvendit të Kosovës, për shkak të barrierave fizike, të cilat nuk i lejojnë të njëjtit të hyjë dhe dal i pavarur në objektin e Kuvendit, për shkak të mungesës së qasjes për persona me karrocë.

OPAK-ët, kanë përcjellë mesazhin tek institucionet që këto barriera nuk duhet të ekzistojnë dhe kanë kërkuar që të merren veprime konkrete për ta rregulluar qasjen në objektin e Parlamentit të Kosovës. Përgjegjësit në Parlament i kanë siguruar deputetët ndihmën e asistentit, por që kjo zgjidhje nuk është alternative më e mirë sepse nuk ofron qëndrueshmëri dhe nuk siguron vazhdimësi.



OPAK-ët, gjatë vitit 2020, kanë organizuar dhe mbajtur Javën Ndërkombëtare të Njeriut me Shkop të Bardhë dhe Javën e personave të shurdhër, e përcjellë me konferenca dhe takime me institucione. Përmes marshimit në sheshin kryesor të Prishtinës është shënuar dita ndërkombëtare e përdoruesve të karrocave, me pjesëmarrjen e Kryetares së Parlamentit, ish Kryeministrit, deputeteve, personaliteteve tjera publike dhe qytetareve. Përmes këtyre organizimeve janë përçarur mesazhe për avancimin e të drejtave për personat me aftësi të kufizuara, zbatimin e ligjeve qasshmërinë dhe gjithë-përfshirjen. Të gjitha këto ngjarje janë përcjell edhe nga mediat vizuale, elektronike dhe mediat sociale.

Këtë vit, në mënyrë të konsiderueshme është ngritur prania/vizibiliteti i personave me aftësi të kufizuara në media, përfshirë ato vizualë, të shkruara dhe mediat sociale.

Për qëllimet e këtij raporti janë përfshirë detyrimet e mëposhtme:

Fushat e hulumtimit	Fusha e Intervenimet gjate vitit 2020	Aktivitetet/Lloji I intervenimit
Personat me aftësi të kufizuara janë pjesë e jetës politike dhe publike mbi baza të barabarta me të tjerët (e drejta e votës dhe e zgjedhjes	E aplikuar	Avokimi për zgjedhje në parlament
Personat me aftësi të kufizuara gëzojnë mjedis mbështetës për pjesëmarrje të plotë dhe jo diskriminuese në punët publike	E aplikuar	Avokim për mënjanimin e barrierave fizike për pjesëmarrje në jetën publike
Qasja e personave me aftësi të kufizuara në materialin kulturor/	E aplikuar	Prania në media vizualë, te shkruara dhe mediat sociale
Qasja e personave me aftësi të kufizuara në programe televizive, filma, teatër dhe aktivitete të tjera kulturore/	E aplikuar	Prezenca me TV, aktivitete sportive
Qasja e personave me aftësi të kufizuara në institucionet dhe monumentet e trashëgimisë kulturore.	NA	

## 6. Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë

Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar është kategoria më e dobët në mesin e dhjetë kategorive të vlerësuara në këtë studim. Asnjë nga standardet e mëposhtme nuk është pjesë e legjislacionit të Kosovës.

Në reference të bashkëpunimit ndërkombëtarë, me gjithë sfidat që ka sjellë pandemia, OPAK-et kanë bërë përpjekje për bashkëpunime ndërkombëtare. SHVK është pranuar në Unionin Evropian të verbërve, si anëtare vëzhgues dhe mbajtja e takimit “online” për traktatin e Marrakeshit<sup>8</sup>, me qëllim të avokimit tek institucionet nacionale për realizimin e të drejtës autoriale për botimin e veprave të autorëve të ndryshëm për shkrimin Brail.

Për qëllimet e këtij raporti janë përfshirë detyrimet e mëposhtme:

<sup>8</sup> <http://www.euroblind.org/campaigns-and-activities/current-campaigns/marrakesh-treaty>

Fushat e hulumtimit	Fusha e Intervenimet gjate vitit 2020	Aktivitetet/Lloji I intervenimit
Mbledhja, analizimi dhe publikimi i të dhënave statistikore mbi gjendjen e personave me aftësi të kufizuara	NA	
Programet e zhvillimit ndërkombëtar janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara	E aplikuar	SHVK është pranuar ne Unionin Evropian të Verbërve, si anëtare vëzhgues.
Sigurimi i mbështetjes për zhvillimin e kapaciteteve përmes ndarjes dhe shkëmbimit të informacionit, trajnimit dhe praktikave më të mira	E aplikuar	Punëtoritë për Ndërtimin e Kapaciteteve të OPAK-ve.
Lehtësimi i bashkëpunimit në hulumtime dhe qasja në njohuritë shkencore dhe teknike	NA	

Në finalizimin e intervenimeve dhe realizimin e të drejtave nga këto fusha dhe avokimin dhe intervenimin për fushat e tjera do ta trajtojmë në vitet në vijim.

## 7. Zhvillimet e tjera

Gjate muajit tetor Zyra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me OPAK-et kanë organizuar punëtorinë pesë (5) ditore me përfaqësuesit e Ministrive relevante dhe si rezultat është hartuar Drafti i parë i Planit Nacional të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021-2023, i bazuar në Strategjinë Nationale për Persona me Aftësinë e Kufizuar.

Gjatë muajit shtator, Ministria e Shëndetësisë së bashku me grupin punues ka finalizuar Udhëzimin Administrative për Pajisje Ndihmese, i cili bazohet në Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Udhëzimi ka kaluar fazat e aprovimit në kuadër të MSH. Pjesë e grupit punues kanë qenë edhe përfaqësuesit e HANDIKOS.

Zyra për Qeverisje të Mirë në bashkëpunim me OPAK-et kanë zhvilluar termet e referimit dhe rregulloren e brendshme për ri-funksionalizimin e Këshillit Nacional të Aftësisë së Kufizuar KNAK. Për shkak të masave qeveritare lidhur me pandeminë, takimi zyrtarë për ri-funksionalizimin e KNAK është shtyrë dhe do të mbahet në rastin e pare me lehtësimin e masave.

## **Rekomandime**

1. Institucionet e nivelit qendror dhe lokal duhet të përfshijnë OPAK-et në të gjitha fazat e procesit të planifikimit, dizajnit, zbatimit dhe monitorimit të veprimeve për rikuperim të përgjithshëm ndaj krizës së krijuar nga COVID 19, përfshirë ofrimin e shërbimeve të domosdoshme për personat me aftësi të kufizuar.

2. Institucionet qendrore dhe lokale të sigurojnë zbatimin e plote të legjislacionit pozitivë në Kosovë lidhur me qasjen, përfshirë këtu aktet nënligjore.

2.1 Të monitorohet respektimi i përmbushjes së kriterëve për qasjen në të gjitha kontratat e lidhura në prokurimin publik. Drejtoritë respektive komunale të monitorojnë zbatimin e kriterëve të Udhëzimit Administrative 33/2007, për qasjen fizike në rastin dhënies së lejeve të ndërtimit për kompanitë e ndërtimit.

2.2 Institucionet qendrore dhe lokale të sigurojnë zbatimin e plote të Rregullores QRK Nr. 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës, është miratuar në mbledhjen e 197 të Qeverisë së Kosovës, me qëllim që personat e shurdhër të kenë qasje të plote në informata dhe shërbime.

2.3 Institucionet qendrore të sigurojnë zhvillimin dhe zbatimin e sintezës vokale në gjuhën shqipe për personat e verbër në mënyrë që ky komunitet të ketë qasje në informata, edukim dhe shërbime.

3. Institucionet Arsimore të sigurojnë programe adekuate dhe qasje për përfshirjen e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuar në procesin e rregullte arsimore në të gjitha nivelet.

3.1 Të sigurojnë mësuesit/asistentet mbështetës në klasa për të gjithë llojet e aftësisë së kufizuar.

4. MPMS të sigurojë krijimin e mekanizmave për zbatimin e Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

4.1 MPMS të siguroj përfshirjen e Ligjit Gjithëpërfshirës në programin legjislativ për vitin 2021.

5. Të obligohen Transmetuesit e Mediave Publik që të rezervojnë një hapësirë kohore me fokus në aftësinë e kufizuar.

5.1 Të ngritën kapacitete dhe njohuritë e gazetareve për çështjet e aftësisë së kufizuar,

6. Institucionet e Kosovës të ofrojnë mbështetje financiare dhe logjistike për anëtarësimin dhe pjesëmarrjen e OPAK-ve në rrjetet e organizatave ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar.

7. Qeveria e Kosovës - Kryeministri të ri-funksionalizim Këshillin Nacional të Aftësisë së Kufizuar.

7.1 Qeveria të zotojë mjete dhe të sigurojë zbatimin e plote të Planit Nacional të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021-2023.